



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 653 Akti

Nr. 674 Vendimi

Tiranë, më 15.6.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 14.6.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 1, salla Ovale, Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Elena Pelushi**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, subjektin e rivlerësimit, znj. Elena Pelushi, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Steven Kessler, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elena Pelushi, aktualisht me detyrën e inspektorit të komanduar pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, është subjekt rivlerësimi që i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ushtronte detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Olsi Komici dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

3. Me vendimin datë 15.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Elena Pelushi, si dhe caktoi kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Valbona Sanxhaktari. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues dhe subjekti i rivlerësimit, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Steven Kessler.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për të tria kriteret e vlerësimit.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 2.6.2023 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Elena Pelushi, bazuar në të tria kriteret, si dhe njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 5.6.2023 mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht i zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

8. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka dërguar nëpërmjet *email*-it datë 8.6.2023 prapësimet dhe provat, në lidhje me rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

9. Komisioni, bazuar në vendimin e tij datë 9.6.2023, nëpërmjet postës elektronike, datë 9.6.2023, e njoftoi subjektin për seancën dëgjimore të datës 14.6.2023 (ora 10:00).

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 14.6.2023 (ora 10:00), në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

11. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Znj. Elena Pelushi ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, duke respektuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

14. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Elena Pelushi, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin tri kritere: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; vlerësimin e aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

15. ILDKPKI-ja ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm e të arsyetuar¹. Në përfundim të veprimeve verifikuese, bazuar në pikën 5 të

¹ ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2018, ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Elena Pelushi.

nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Komisioni, nga ana e tij, vëren se në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë, sipas nenit 31/1² të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti Elena Pelushi ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 20.1.2017, brenda afatit-30 ditor nga hyrja në fuqi³ e ligjit. Pas analizimit të kësaj deklarate, raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacioneve të marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

❖ Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit

1. Gjendje e llogarisë së pagës, në datën 20.1.2017, në Raiffeisen Bank, Durrës, në vlerën 628,761.75 lekë. Pjesa takuese: 100%. Në këtë llogari page, në datën 12.3.2012, është hapur depozitë me afat 12-mujor, në shumën 200,000 lekë.

1.1 Raiffeisen Bank⁴ konfirmon llogarinë e pagës në emër të subjektit të rivlerësimit, me gjendje 628,761.75 lekë, në datën 20.1.2017. Në këtë llogari janë kredituar pagat e subjektit nga muaji shtator i vitit 2007 e në vijim. Me shumën e akumuluar nga pagat e patërhequra, subjekti i rivlerësimit ka hapur në vitin 2012 një depozitë bankare me afat 1-vjeçar, në shumën 200,000 lekë. Me maturimin e depozitës në vitin 2013, pasi ka shtuar nga pagat edhe 150,000 lekë, ka hapur një depozitë të re prej 358,820 lekësh, e cila pas maturimit në mars 2014 nuk është rinovuar, por ka qëndruar si gjendje në llogarinë e pagës. Sipas veprimeve bankare rezulton se në datën 30.4.2014 subjekti i ka paguar shtetasit J. M. nga kjo llogari shumën 429,300 lekë, për blerjen e automjetit tip “Toyota Yaris”. Si burim krijimi për pagesën e çmimit 429,300 lekë ka shërbyer depozita e maturuar më 12.3.2014, në shumën 370,930 lekë dhe diferenca nga pagat e akumuluar.

1.2 Në DIPP-të përkatëse, subjekti ka deklaruar me saktësi gjendjet e llogarisë së pagës në fund të vitit, si dhe veprimet në lidhje me krijimin e depozitave të çelura me fondet nga kjo llogari.

² Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

³ Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës së botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.16, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë, deri më 19.1.2017. Në datën 18.1.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.1.2017. Si rezultat, afati 30-ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin ka përfunduar në datën 31.1.2017.

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 24.2.2021.

1.3 Për sa më lart, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë pasuri.

2. Automjet tip “Toyota Yaris”, me targë *, vit prodhimi 2004, blerë nga shtetasi J. M.,** duke e kryer pagesën nga llogaria e pagës dhe sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.5.2014. Vlera 3,000 euro, sipas kontratës dhe e konvertuar nga banka në 429,300 lekë. Pjesa takuese: 100%.

2.1 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e këtij automjeti si më lart.

2.2 Komisioni, ndër të tjera, ka administruar dokumentacionin: (i) kontratë shitjeje automjeti⁵, datë 2.5.2014, e lidhur midis shitësit J. M. dhe blerësit Elena Bakallbashi⁶, për blerjen e automjetit tip “Toyota Yaris”, me targë ***, vit prodhimi 2004, me çmimin 3,000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale; (ii) leje qarkullimi automjeti dhe certifikatë pronësie, datë 28.5.2014, në emër të subjektit të rivlerësimit; (iii) nxjerrje të llogarisë së subjektit në Raiffeisen Bank, datë 6.3.2015, ku konfirmohet kalimi i shumës 429,300 lekë (ose 3,000 euro) nga llogaria bankare e subjektit në llogarinë bankare të shitësit J. M..

2.3 Komisioni administroi⁷ dhe shqyrtoi dosjen e këtij automjeti, nga ku rezulton edhe: (i) leja e qarkullimit dhe certifikata e pronësisë, datë 20.2.2008, në emër të shitësit J. M., i cili e ka zhdoganuar automjetin më 19.11.2007, me vlerë totale 811,406 lekë (5,000 euro çmimi x 122 kursi këmbimit + 201,406 taksa doganore); (ii) faturë shitjeje datë 16.11.2007, nga shoqëria “****”, ***, Itali, në favor të blerësit J. M., kundrejt vlerës 5,000 euro.

2.4 Komisioni hetoi për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe shtetasit J. M., por nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë⁸.

Analiza financiare e burimit të krijimit të kësaj pasurie

2.5 Në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar se pagesa për blerjen e këtij automjeti është kryer nga llogaria e saj e pagës. Sipas veprimeve bankare, rezulton se në datën 30.4.2014 subjekti i ka paguar shtetasit J. M. nga kjo llogari shumën 429,300 lekë, për blerje automjeti tip “Toyota Yaris”. Si burim krijimi për pagesën e çmimit ka shërbyer depozita e maturuar më 12.3.2014, në shumën 370,930 lekë dhe diferenca nga pagat e akumuluar.

2.6 Për sa më lart, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe nuk konstatoi problematika në lidhje me deklarimin dhe burimin e krijimit të automjetit tip “Toyota Yaris”, të blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2014.

3. Depozitë në shumën 200,000 lekë, e hapur më 27.11.2012, në Credit Agricole Bank (sot ABI Bank), Durrës, me rinovim automatik tremujor. Për hapjen e kësaj depozite është autorizuar transfertë fondesh në shumën 200,000 lekë nga llogaria e pagës në Raiffeisen Bank, në datën 22.11.2012, për tek Credit Agricole Bank, ku është hapur depozita e kursimit.

⁵ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.5.2014, notere A. S..

⁶ Mbiemri i familjes së origjinës.

⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2023, të DPSHTRR-së, drejtuar Komisionit.

⁸ Shkresë nr. *** prot., maj 2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

3.1 ABI Bank⁹ (ish-Credit Agricole) konfirmon gjendjen e llogarisë bankare në shumën 213,278.35 lekë, të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Nga veprimet bankare konfirmohet gjithashtu edhe transferimi i shumës 200,300 lekë në datën 22.11.2012, nga llogaria e pagës në Raiffeisen Bank dhe krijimi me këtë shumë i depozitës bankare. Kjo depozitë është shtuar ndër vite me interesa bankarë që janë deklaruar në mënyrë të saktë në DIPP-të periodike nga subjekti i rivlerësimit.

3.2 Gjithashtu konfirmohet edhe gjendja e llogarisë së kursimit në shumën 11.21 lekë, sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit.

3.3 Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me deklaramin dhe burimin e krijimit të kësaj depozite bankare.

4. Gjendje cash në shumën 500,000 lekë, nga kursimet nga paga ndër vite. Pjesa takuese: 100%.

4.1 Pas shqyrtimit të deklarimeve të gjendjes *cash* ndër vite nga ana e subjektit dhe bashkëshortit të saj, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë deklaramet periodike në lidhje me gjendjen *cash* dhe të përcaktojë gjendjen e tij në datën 31 dhjetor të çdo viti. Subjekti, në përgjigje të saj, ka deklaruar si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 1

DIPP	Deklarimi i gjendjes <i>cash</i> në deklaratat periodike	Gjendja <i>cash</i> në datën 31 dhjetor të çdo viti, sipas pyetësorit nr. 3	Shpjegimet në pyetësorin nr. 3
2008	Subjekti: “ <i>Kursime nga paga, para në cash në shtëpi 200,000 lekë.</i> ”	200 000	
2009	Subjekti: “ <i>Kursime nga paga, para në cash në shtëpi 400,000 lekë.</i> ”	600 000	Shtuar 400,000 lekë
2010	Subjekti: “ <i>Kursime nga paga, para në cash në shtëpi 500,000 lekë. Harxhuar nga kursimet nga paga në cash, të deklaruar vitin e kaluar për blerje të disa pajisjeve për përdorim shtëpiak.</i> ”	700 000	Shtuar 500,000 lekë, pakësuar 400,000 lekë
2011	Subjekti: “ <i>Kursime nga paga, para në cash në shtëpi 400,000 lekë.</i> ”	1 100 000	Shtuar 400,000 lekë
2012	Subjekti: “ <i>Pakësuar nga kursimet shuma prej 400,000 lekësh nga paratë cash të kursyera në vitin e kaluar, pasi ia kam dhënë nënës sime.</i> ”	700 000	Pakësuar 400,000 lekë
2013	***	700 000	Pa deklaruar ndryshime
2014	Subjekti: “ <i>Shitur autovetura me targë ***, e markës Volkswagen 1H Golf, vit prodhimi 1992, me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.8.2014. Automjeti i është shitur shtetasit E. L. Kjo shumë parash është mbajtur gjendje cash. Vlera: 70,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.</i> ”	700 000	Gjendja <i>cash</i> në fund të vitit 2014 ka qenë në vlerën 700,000 lekë, bazuar në deklaramin e bërë në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 14.12.2015.

⁹ Shkresat nr. *** prot., datë 5.2.2021 dhe nr. *** prot., datë 16.3.2023.

2015	Bashkëshorti: “Kursime ndër vite si mësuës. Cash në shtëpi. Shuma 250,000 lekë”.	Subjekti 700 000 Bashkëshorti 250 000	
2016	Subjekti: “Harxhuar nga kursimet nga paga – gjendja cash 200,000 lekë. Pjesa takuese: 100%”. Bashkëshorti: “Shitur autovetura me targë ***, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.5.2016, në vlerën 3,800 euro. Nga kjo shitje janë mbajtur si kursime cash 1,000 euro. Pjesa takuese: 100%.”	Subjekti 500 000 ----- Bashkëshorti 250 000 + 1 000 euro	Pakësuar 200,000 lekë ----- ---- Shtuar 1 000 euro
Vetting 20.1.2017	Subjekti: “Gjendja cash 500,000 lekë nga kursimet nga paga ndër vite. Pjesa takuese: 100%.” Bashkëshorti: “Kursime në cash 1,000 euro nga shitja e mjetit dhe 200,000 lekë kursime ndër vite nga puna si mësuës”.	Subjekti 500 000 ----- Bashkëshorti 200 000 + 1 000 euro	----- ---- Pakësuar 50,000 lekë

4.2 Me pyetësonin nr. 2, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit sqarime lidhur me deklarinin në: (i) DIPP-në e vitit 2012, konkretisht të shpjegojë destinacionin e shumës 400,000 lekë që i ka dhënë nënës; (ii) DIPP-në e vitit 2016, konkretisht të shpjegojë deklarinin se cilave likuiditete i referohet si “të harxhuara” dhe çfarë përfaqëson shuma 200,000 lekë; (iii) të shpjegojë në mënyrë kronologjike krijimin e gjendjes *cash* prej 500,000 lekësh, të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

4.3 Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

- i) shumën 400,000 lekë ia ka dhënë nënës së saj për t’i përdorur ku t’i nevojiteshin;
- ii) shuma 200.000 lekë është me burim të ardhurat nga paga ndër vite, që sipas deklaratave është deklaruar kursim *cash* dhe nuk është deklaruar si e përdorur/e pakësuar;
- iii) shuma 500,000 lekë, e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, është pjesë e gjendjes *cash* të krijuar nga kursimet nga pagat përgjatë viteve, referuar atyre të deklaruara përgjatë viteve sipas deklarimeve periodike vjetore, e cila nuk është deklaruar si e përdorur/e pakësuar.

4.4 Komisioni, pas leximit të deklaratave periodike, përgjigjeve të dhëna nga subjekti në pyetësorë, si dhe shpjegimeve të dhëna prej saj në ILDKPKI, vëren se ecuria kronologjike e krijimit dhe deklarimit të gjendjes *cash* të subjektit ndër vite përputhet me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

4.5 Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar, si dhe nuk konstatoi problematika në lidhje me deklarinin dhe burimin e krijimit të gjendjes *cash* të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të/bashkëshortit.

❖ Pasuri të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. M. P.

5. Apartament me sip. 100 m², me nr. pasurie *, z. k. ***, vol. ***, f. ***, Tiranë,** blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesa nr. ***, Tiranë, me kontratë shitjeje datë 15.2.1994, me blerës H., V. dhe M. P., në vlerën 24,510 lekë. Me vdekjen e babait H. P., në datën 13.7.2016, është çelur akti i dëshmisë së trashëgimisë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.11.2016 dhe pas regjistrimit në ZVRPP-në Tiranë, në datën 6.12.2016, është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie në emër të shtetasve M. P. me 5/12 pjesë, V. P. me 5/12 pjesë dhe Xh. M. e V. D., vajzat e trashëgimlënësit, me nga 1/12 secila.

5.1 Në DIPP-në e vitit 2017, me anë të deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.3.2017, bashkëpronaret Xh. M. dhe V. D. (motrat e shtetasit M. P.) kanë deklaruar se heqin dorë nga pjesët e tyre takuese në apartament prej 1/12 pjesë të pandarë. Kjo deklaratë noteriale është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, e cila në datën 8.4.2017 ka lëshuar certifikatën e pronësisë për këtë apartament në emër të shtetasve M. P. dhe V. P., me nga 1/2 pjesë.

5.2 ASHK Tiranë Veri konfirmon¹⁰ regjistrimin e këtij apartamenti në emër të shtetasve M. P. dhe V. P., si dhe historikun e kësaj pasurie, që përputhet me deklarinimin e bashkëshortit të subjektit.

5.3 UKT-ja konfirmon¹¹ se në emër të shtetasit M. P. figuron e lidhur aktive kontrata familjare e furnizimit me ujë nr. ***, në adresën rruga “***”, Tiranë.

5.4 FSHU-ja konfirmon¹² se në emër të shtetasit M. P. është lidhur në datën 15.12.1997 kontrata e furnizimit me energji elektrike nr. ***, në adresën rruga “***”, Tiranë.

5.5 Referuar certifikatës së martesës datë 18.1.2017, që subjekti i rivlerësimit ka depozituar bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, rezulton se martesë e saj me bashkëshortin M. P. është lidhur në datën 27.4.2015.

5.6 Për sa më lart, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëshorti, me dokumentacionin e administruar.

Komisioni konstaton se kjo pasuri është krijuar në periudhën para emërimit të subjektit të rivlerësimit në detyrë dhe para martesës me bashkëshortin e saj M. P..

6. Kursime cash në vlerën 1,000 euro, nga shitja e automjetit me targë *, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.5.2016, në vlerën 3,800 euro.** Shuma tjetër prej 2,500 euro është shpenzuar për trajtime shëndetësore për babain, si dhe për shërbimin funeral. Pjesa takuese: 100%.

6.1 Në DIPP-në e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar blerjen e këtij automjeti me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.5.2014, në vlerën 50,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

6.2 Në DIPP-në e vitit 2016, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar shitjen e automjetit sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.5.2016, në vlerën 3,800 euro. Nga kjo shitje është mbajtur si kursim *cash* vlera 1,000 euro. Pjesa takuese: 100%.

6.3 Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka depozituar: (i) kontratë shitjeje automjeti¹³, datë 5.5.2014, e lidhur midis shitësit N. L. dhe blerësit M. P., për blerjen e automjetit tip “Opel Astra” me targë ***, vit prodhimi 2005, me çmimin 50,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale; (ii) kontratë shitjeje automjeti¹⁴, datë 31.5.2016, e lidhur midis shitësit M. P. dhe blerësit L. J., për shitjen e këtij automjeti me çmimin 3,800 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

6.4 Komisioni administroi nga DPSHTRR-ja¹⁵ dosjen e këtij automjeti dhe pas shqyrtimit të saj rezultoi se sipas certifikatës së pronësisë datë 9.5.2014, automjeti është regjistruar në emër të

¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.5.2023, drejtuar Komisionit.

¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.3.2021, të UKT-së, drejtuar Komisionit.

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2021, të FSHU-së, drejtuar Komisionit.

¹³ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.5.2014, noter I. Q..

¹⁴ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.5.2016, notere M. J..

¹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021, të DPSHTRR-së, drejtuar Komisionit.

shtetasit M. P. Shtetasja N. L. (shitësja e automjetit) e ka blerë këtë automjet me çmimin 2,000 euro nga shtetasi A. Sh., sipas kontratës së shitjes datë 21.1.2014.

6.5 Komisioni hetoi për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe shtetases N. J., por nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë¹⁶.

6.6 Rezulton se kjo pasuri është blerë para datës së martësës, 27.4.2015, të personit të lidhur M. P. me subjektin e rivlerësimit.

6.7 Me anë të pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë: (i) blerjen e këtij automjeti nga bashkëshorti me një çmim rreth 6 herë më të ulët se çmimi i blerjes nga ish-pronarja N. L., para 4 muajve; (ii) në çfarë rrethanash është njohur bashkëshorti me këtë shtetase; (iii) të provojë me dokumentacion ligjor shtesën e vlerës së këtij automjeti, i cili pas 2 vitesh është shitur nga bashkëshorti me një çmim rreth 10 herë më të lartë se çmimi me të cilin e bleu ai vetë.

6.8 Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se:

i) Referuar datës së kontratës së lidhur, 5.5.2014, automjeti është blerë nga bashkëshorti përpara martësës me subjektin. Bashkëshorti nuk ka dijeni për vlerën me të cilën shitësja N. L. e kishte blerë automjetin. Gjithsesi, për sa i përket çmimit të blerjes së automjetit, bashkëshorti i ka sqaruar subjektit se kur e ka blerë atë, përveç shumës 50,000 lekë, sipas kontratës së shitjes datë 5.5.2014, i ka dhënë shitëses edhe automjetin tjetër tip “Volkswagen Golf 4”, me targë ***, që bashkëshorti kishte në pronësi në atë kohë. Ky veprim reflektohet tek prokura e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.5.2014, nënshkruar nga bashkëshorti i subjektit M. P. dhe bashkëshorti i blerëses së automjetit, z. E. L., ku z. M. P. ka emëruar si përfaqësues të posaçëm z. E. L., duke deklaruar në prokurë se është likuiduar financiarisht prej tij për shitjen e automjetit, i cili është dorëzuar tek përfaqësuesi në datën 2.5.2014, në gjendje të mirë pune e teknike. Automjeti në fjalë është shitur nga shtetasi E. L. në fund të muajit maj të vitit 2014, në vlerën 180,000 lekë.

ii) Subjekti shpjegon se bashkëshorti i ka sqaruar që njohja me bashkëshortët L. ka qenë rastësore, nëpërmjet një kushëriri, të cilit i kishte shprehur interesin për blerjen e një automjeti dhe kjo njohje ka përfunduar në momentin kur është lidhur kontrata e shitjes dhe njëkohësisht kur është dorëzuar automjeti tjetër me targë ***, me anë të prokurës së lëshuar, e cila është nënshkruar edhe nga përfaqësuesi.

iii) Bashkëshorti e ka shitur automjetin me targë ***, me çmimin 3,800 euro (pas testimi të tregut referuar modelit, tipit të automjetit dhe gjendjes shumë të mirë teknike) tek një blerës që nuk e njihnte më parë dhe me të cilin nuk pati marrëdhënie as pas shitjes.

6.9 Në përfundim, subjekti sqaron se referuar këtyre rrethanave, si dhe shpjegimeve më lart, çmimi i shitjes së automjetit nga bashkëshorti M. P., në raport me çmimin e blerjes prej tij, nuk mund të vlerësohet si një diferencë e paarsyeshme.

6.10 Komisioni ka administruar¹⁷ dosjen e automjetit tip “Volkswagen Golf 4”, me targë ***, të cilin subjekti pretendon se bashkëshorti i saj ia ka dhënë shtetasit E. L. si pjesë e çmimit me të cilin bleu automjetin me targë ***, në datën 5.5.2014.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., maj 2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

¹⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021, të DPSHTRR-së, drejtuar Komisionit.

6.11 Nga shqyrtimi i dosjes ka rezultuar se bashkëshorti i subjekti ka pasur në pronësi automjetin tip “Volkswagen Golf 4”, vit prodhimi 1999, me targë ***, të cilin e ka blerë nga shtetasja A. G. me çmimin 200,000 lekë, sipas kontratës¹⁸ datë 22.10.2007 (përpara martesës me subjektin). Me kontratë shitjeje¹⁹ datë 31.5.2014, shtetasi M. P. (i përfaqësuar me prokurën e posaçme datë 5.5.2014 nga shtetasi E. L.) ia ka shitur automjetin blerësve A. e E. G., me çmimin 180,000 lekë, të likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe sipas lejes së qarkullimit datë 6.8.2014, ky automjet figuron në emër të shtetasve A. e E. G.

6.12 Komisioni, me pyetësonin nr. 4, i ka kërkuar subjektit të shpjegojë se për çfarë çmimi është likuiduar bashkëshorti i saj për automjetin tip “Volkswagen Golf 4”, që ia ka dhënë shitësit E. L. si pjesë e çmimit të blerjes nga bashkëshorti të automjetit me targë ***, përfshirë edhe shumën 50,000 lekë.

6.13 Subjekti ka shpjeguar se çmimi i blerjes së automjetit me targë ***, nga bashkëshorti, ka qenë 50,000 lekë plus automjetin tip “Volkswagen Golf 4”, por pa u përcaktuar vlerë për këtë automjet.

6.14 Referuar sa më sipër, duke qenë se automjeti tip “Volkswagen Golf 4” është shitur po brenda muajit maj 2014 nga shtetasi E. L., përfaqësues me prokurë të posaçme i bashkëshortit të subjektit, për çmimin 180,000 lekë, Komisioni e pasqyroi këtë vlerë në analizë financiare si çmim shitjeje të këtij mjete nga ana e bashkëshortit të subjektit e, për rrjedhojë, duke pasqyruar në analizën financiare si çmim blerjeje të automjetit me targë *** vlerën 230,000 lekë (50,000 lekë + 180,000 lekë).

6.15 Për sa më lart, referuar dokumentacionit të administruar; përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësonin nr. 2 dhe dokumentacionit bashkëlidhur, Komisioni vëren se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar në lidhje me kursimet në vlerën 1,000 euro nga shitja e automjetit me targë ***; bashkëshorti i subjektit e ka blerë këtë automjet në datën 5.5.2014, me çmimin 230,000 lekë ose 1,643 euro dhe e ka shitur pas 2 vjetësh në datën 31.5.2016, me çmimin 3,800 euro. Nga ana tjetër, subjekti nuk e provoi shtesën e vlerës së automjetit prej 2,157 euro (3,800 euro – 1,643 euro). Për këtë arsye, për efekt të analizës financiare, Komisioni mori në konsideratë çmimin e blerjes prej 1,643 euro si vlerë e të ardhurave të realizuara nga shitja e këtij automjeti.

6.16 Për sa më lart, Komisioni konstatoi se duket se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëshorti M. P.: (i) ka pasur mundësi financiare për të krijuar kursime *cash* në vlerën 1,000 euro, nga shitja e automjetit me targë ***; (ii) nuk ka arritur të justifikojë me dokumentacion ligjor vlerën e shtuar prej 2,157 euro për automjetin me targë ***, blerë me çmimin 1,643 euro dhe shitur për vlerën 3,800 euro, pra me një çmim më të lartë se ai i blerjes.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

6.17 Në prapësimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se automjeti i shitur me *** ka qenë 100% në pronësi të bashkëshortit të saj. Ky i fundit ka fituar pronësinë për automjetin në fjalë,

¹⁸ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.10.2007, noter I. Q..

¹⁹ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., *** kol., datë 31.5.2014, notere E. H..

para martesës me subjektin e rivlerësimit dhe në cilësinë e pronarit të vetëm ka proceduar me shitjen e automjetit pas testimit prej tij të tregut referuar modelit, tipit dhe gjendjes shumë të mirë teknike.

Vlerësimi i Komisionit

6.18 Referuar çmimit të shitjes së automjetit prej 3,800 euro, pra dy herë më i lartë se çmimi i blerjes prej 1,643 euro, afatit dyvjeçar të përdorimit, vitit të prodhimit të automjetit, si dhe faktit që subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor rritjen e vlerës së automjetit që nga data e blerjes nga bashkëshorti në datën e shitjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk u vlerësuan bindëse për Komisionin.

6.19 Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të justifikojë me dokumentacion ligjor vlerën e shtuar prej 2,157 euro për automjetin me targë ***, të blerë me çmimin 1,643 euro dhe shitur në vlerën 3,800 euro, pra me një çmim më të lartë se ai i blerjes.

7. Kursime cash ndër vite në banesë, nga puna në mësimdhënie në periudhën 1995 – 2015. Vlera: 200,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

7.1 Në DIPP-në e vitit 2015, ka deklaruar: *“Kursime 250,000 lekë ndër vite cash në shtëpi, nga puna si mësues në shkollën 8-vjeçare “****” në Bashkinë Vorë, në periudhën 1995 – 2002; mësues në shkollën jopublike shqiptaro-amerikane “****” për periudhën 2007, 2012 – 2014; as. pedagog në Universitetin e Tiranës në periudhën 2002 e në vazhdim. Pjesa takuese: 100%.”*

7.2 Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka depozituar dokumentacionin që vërteton punësimin dhe pagesat përkatëse²⁰.

7.3 Nga leximi i deklaratave periodike rezulton se shtetasi M. P., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar gjendjen e kursimeve *cash* në fund të çdo viti. Në DIPP-në e vitit 2015, shtetasi M. P. ka deklaruar kursime *cash* në shumën 250,000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2016, shtetasi M. P. ka deklaruar gjendje *cash* shumën 1,000 euro, me të ardhurat nga shitja e mjetit. Në deklaratën *Vetting*, shtetasi M. P. ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 200,000 lekë dhe 1,000 euro.

7.4 Në shpjegimet e dhëna në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit deklaroi se gjendja *cash* e deklaruar në deklaratën *Vetting* është krijuar me kursimet ndër vite, të cilat janë deklaruar prej tij nga viti 2015.

7.5 Për sa më lart, Komisioni konstatoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të saktë gjendjen *cash* në deklaratën *Vetting*.

8. Gjendje në llogarinë e pagës nr. *, në Credins Bank, Tiranë, në datën 20.1.2017, në vlerën 5,597.12 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

²⁰ (i) Vërtetim page nga Bashkia Vorë për pagat neto të shtetasit M. P., për periudhën janar 1006 – korrik 2002; (ii) vërtetim nr. ***, datë 1.3.2016, nga shkolla “Protagonistët”, për pagat neto për periudhën prill 2007 – qershor 2014; (iii) vërtetim datë 29.2.2016, nga Universiteti i Tiranës, për pagat neto për periudhën korrik 2002 – dhjetor 2015; (iv) vërtetim datë 17.10.2016, nga Universiteti i Tiranës, për pagat neto për periudhën janar 2016 – tetor 2016; (v) vërtetim datë 9.1.2017, nga Universiteti i Tiranës, për pagat neto për periudhën tetor 2016 – nëntor 2016.

8.1 Subjekti ka deklaruar gjendjen e kësaj llogarie në DIPP-të e viteve 2016 dhe 2017, duke bashkëlidhur përshkrimin e llogarisë së tij nr. *** në Credins Bank, datë 20.1.2017. Credins Bank²¹ konfirmon gjendjen e llogarisë së pagës të deklaruar nga bashkëshorti i subjektit.

8.2 Për sa më lart, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe nuk konstatoi problematika në lidhje me deklarinimin dhe burimin e krijimit të llogarisë së pagës në Credins Bank.

❖ **Konstatime të tjera për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj**

9. Në lidhje me adresat e banimit, referuar deklaramëve vjetore dhe atyre në pyetësorë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni vëren se:

9.1 Në DDPD-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Apartament 1+1, me sip. 56 m², vlera 6,095 lekë, pjesa 12%, i blerë nga Ndërmarrje Komunale Banesa, Durrës, sipas kontratës së shitblerjes datë 4.9.1993, nga nëna, babai dhe vëllai si bashkëpronarë. Unë jam bërë bashkëpronare pas vdekjes së babait”*. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar shitjen e këtij apartamenti me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.5.2007, për çmimin 2,600,000 lekë.

9.1.1 Komisioni administroi²² dhe shqyrtoi dosjen e kësaj pasurie, nga ku rezultoi se: (i) me kontratë shitjeje datë 4.9.1993, shtetasit J., Z. dhe K. B. kanë blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesa këtë apartament, të deklaruar nga subjekti; (ii) me vendimin datë 27.5.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është çelur dëshmia e trashëgimisë për trashëgimlënësin Z. B., duke përcaktuar trashëgimtarët J., K. dhe Elena Bakallbashi me 1/3 pjesë; (iii) me kontratë shitjeje²³ datë 31.5.2007, bashkëpronarët J., K. dhe Elena Bakallbashi ia kanë shitur këtë pronë shtetasit M. N. K., me çmimin 2,600,000 lekë, që shitësi e ka depozituar në datën 31.5.2007 në llogarinë bankare të shtetasës J. B. pranë Raiffeisen Bank.

9.1.2 Nga kërkimi në ASHK²⁴ rezulton se ky apartament, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, është regjistruar në emër të shtetasit M. N. K..

9.1.3 Raiffeisen Bank²⁵ konfirmon depozitimimin e shumës 20,883.53 euro nga shtetasi M. K., në datën 31.5.2007, në llogarinë e nënës së subjektit të rivlerësimit.

9.1.4 Komisioni vëren se kjo pasuri është krijuar para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, e cila gjatë periudhës në detyrë ka fituar bashkëpronësinë mbi këtë pasuri për shkak të trashëgimisë ligjore nga babai i saj.

9.1.5 Për sa më lart, Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë pasuri.

9.2 Duke qenë se pasuria apartament, në pronësi të nënës së subjektit, me adresë rruga “****”, Lagjja nr. ***, pallati ***, Durrës, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si pasuri e përdorur prej saj për banim përpara martesës, si një anëtare e familjes së origjinës, Komisioni kreu një hetim

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.3.2021.

²² Me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2021, të ASHK-së Durrës, drejtuar Komisionit.

²³ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.5.2007, noter M. Rr..

²⁴ Shihni shfletuesin e arkivit të ASHK-së, datë 7.4.2023.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 24.2.2021.

në lidhje me dokumentacionin dhe ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, me qëllim për të verifikuar nëse kemi të bëjmë ose jo me një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

9.2.1 Në pyetësonin nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për periudhën janar 2009 – maj 2015 ka banuar në Durrës, rruga “****”, Lagja nr. ***, pallati ***, në apartamentin në pronësi të nënës. Bashkëlidhur pyetësonit subjekti ka depozituar kontratë sipërmarrjeje datë 7.2.2006, e lidhur midis sipërmarrësit, shoqëria “****” sh.p.k. dhe porositësit J. B., për ndërtimin e apartamentit ***, me sip. 79.3 m², kati ***, në adresën rruga “****”, Durrës, kundrejt çmimit 44,400 euro. Në kontratë është përcaktuar që likuidimi i çmimit do të bëhet me 3 këste (kësti i parë prej 13,300 euro me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes; kësti i dytë prej 15,550 euro brenda datës 31.1.2007; kësti i tretë prej 15,550 euro brenda datës 31.1.2008).

9.2.2 Komisioni hetoi për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit, administratorit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., por nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë²⁶.

9.2.3 Në pyetësonin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit: (i) të japë shpjegime dhe të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të apartamentit, si dhe të depozitojë dokumentacionin ligjor në lidhje me pagesat e kryera për apartamentin; (ii) të depozitojë kontratën e shitjes dhe certifikatën e pronësisë për këtë apartament.

9.2.4 Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se:

i) Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të apartamentit dhe pagesat e kryera për të, ka shpjeguar se çmimi është paguar *cash* me këste në zyrat e shoqërisë ndërtuese, dokumentuar këto pagesa me mandatarkëtime²⁷. Si burim i të ardhurave për blerjen e apartamentit janë përdorur: (a) të ardhurat nga shitje toke; (b) të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm në qytetin e Durrësit; (c) kontribute nga vëllai i saj.

Në lidhje me të ardhurat nga shitje toke, subjekti shpjegon se nëna e saj, si pronare e vetme dhe si bashkëpronare, ka shitur toka të trashëguara²⁸ nga babai i saj M. S. M. (gjyshi i subjektit të rivlerësimit), që ai i kishte përfituar si ish-pronar me vendim të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve²⁹ (KKKPP), Bashkia Durrës, që i ka njohur këtij pronësinë mbi një sipërfaqe toke 20.5 dynym në ***, Lagja nr. ***, Durrës dhe nga kjo sipërfaqe i ka rikthyer në pronësi në natyrë 5,000 m² tokë e lirë, ndërsa diferencën prej 15.5 dynym ia ka kompensuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës i ka kthyer³⁰ edhe një sipërfaqe tjetër prej 4,916 m² dhe më pas³¹ edhe një sipërfaqe prej 2,298 m², si dhe i ka kompensuar me letra me vlerë një sipërfaqe prej 8,228 m².

²⁶ Shkresë nr. *** prot., maj 2023 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

²⁷ (i) Mandatarkëtim nr. ***, datë 7.2.2006 (13.300 euro), me përshkrimin “Kësti i parë për prentim ap. *** tek banesa ****”; (ii) mandatarkëtim nr. ***, datë 16.1.2007 (15.500 euro), me përshkrimin “Arkëtim për apartamentin, objekti ****”; (iii) mandatarkëtim nr. ***, datë 29.1.2008 (15.500 euro), me përshkrimin “Për ap. ***, likuidim kësti”.

²⁸ Si trashëgimtare ligjore e trashëgimlënësit M. S. M. (babai i nënës), sipas dëshmisë ligjore nr. ***, datë 22.9.1993, nga notere L. R. M..

²⁹ Vendim nr. ***, datë 29.11.2004, i KKKPP-së, Bashkia Durrës.

³⁰ Me vendimin nr. ***, datë 13.6.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

³¹ Me vendimin nr. ***, datë 22.2.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Pas pjesëtimit të truallit me sip. 6,426 m² midis bashkëpronarëve, me datë 21.11.1997, për nënën e subjektit është përcaktuar sipërfaqja 714 m², të cilën ajo e ka shitur në cilësinë e pronares së vetme, në datën 11.1.1999, me vlerë 1,950,000 lekë. Këtë shumë parash nëna e subjektit e ka vendosur në depozitë me interesa në Bankën e Kursimeve Durrës. Nëna e subjektit ka vendosur në llogari bankare edhe vlera monetare të siguruara nga shitja e tokave, të cilat ajo i ka pasur në bashkëpronësi me trashëgimtarë të tjerë, por nuk disponon aktualisht librezë nga Banka e Kursimeve apo Raiffeisen Bank, ku ka vendosur paratë si depozita me interesa bankarë.

Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) shkresën nr. *** prot., datë 22.11.2018, e Raiffeisen Bank, Dega Rajonale Durrës, ku shpjegohet se: *“Në lidhje me dy depozitat tuaja të kursimeve që i përkasin vitit 1999 dhe 2007, ...pas kryerjes së verifikimeve në arkivin e bankës, si dhe në të dhënat e regjistruara në sistemin e Raiffeisen Bank sh.a. rezulton... se sipas dokumentacionit të gjetur në arkiv, “Inventar i depozitave të janarit 2001”, në emrin tuaj rezulton një depozitë kursimi me afat 3-mujor, në shumën 2,655,769 lekë...”*; (ii) lëvizjet përkatëse të llogarive lidhur me shumën 2,655,769 lekë. Siç rezulton nga kjo shkresë, kjo shumë parash ka qenë në depozitë në janar të vitit 2001, pra në kohën kur subjekti nuk kishte filluar punë.

Në lidhje me të ardhurat nga shitja e shtëpisë së mëparshme në qytetin e Durrësit, subjekti shpjegon se me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 31.5.2007, është shitur apartamenti i banimit me sip. 56.8 m² (1+1), në Lagjen nr. ***, rruga “****”, Durrës, me çmim 2,600,000 lekë. Blerësi e ka paguar në të njëjtën datë me transfertë bankare në llogarinë bankare të nënës së subjektit, në Raiffeisen Bank³². Raiffeisen Bank, Dega Rajonale Durrës³³, konfirmon depozitim të çmimit të blerjes së apartamentit në shumën 20,883.53 euro, nga ana e blerësit M. K., në llogarinë e nënës së subjektit dhe prej kësaj shume kjo e fundit ka futur në depozitë shumën 14.883 euro. Teprica prej 6,000 euro është tërhequr nga nëna e subjektit në datën 7.6.2007 dhe sipas shpjegimeve të saj është përdorur për të shlyer huan që kishte marrë vëllai K. B. nga punëdhënësi i tij për të paguar këstet e apartamentit të ri. Depozita prej 14,883 euro është tërhequr në datën 29.1.2008 nga nëna e subjektit, tashmë në shumën 15,098.74 euro, për të paguar këstin e tretë të apartamentit.

Në lidhje me kontributet e vëllait, subjekti shpjegon se vëllai i saj që prej vitit 2003 e në vazhdim është i punësuar në Kryepeshkopatën e Tiranës, e cila përballon çdo shpenzim të kryer nga ana e tij³⁴. Vëllai i subjektit është kujdesur dhe vazhdon të kujdeset për nënën dhe motrën, duke kontribuar financiarisht për shpenzime të ndryshme jetese, shëndetësore, banese, etj., si dhe me marrjen e huas në shumën totale 6,500 euro (1,500 euro në datën 7.2.2006 dhe 5,000 euro në datën 15.1.2007) në formën e ndihmës nga punëdhënësi i tij, me qëllim pagimin në kohë të kësteve të apartamentit që kishte porositur nëna në Lagjen nr. ***, Durrës (bashkëlidhur, deklarimi datë 22.4.2023, i vëllait të subjektit, vërtetimi nr. ***, datë 22.4.2023 dhe vërtetimi nr. ***, datë 20.4.2023).

³² Kjo kontratë dhe ky transaksion është deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 dhe në pyetësorin standard, ku janë bashkëlidhur edhe dokumente të origjinës së fitimit të kësaj pronësie.

³³ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.11.2018, të Raiffeisen Bank.

³⁴ Shihni në mënyrë më të detajuar përshkrimin tek rezultatet e hetimit administrativ dhe provat e vëna në dispozicion nga ana e subjektit në lidhje me të ardhurat nga punësimi i të vëllait.

ii) Në lidhje me kërkesën e Komisionit drejtuar subjektit, që të depozitohet kontratën e shitjes dhe certifikatën e pronësisë për apartamentin në pronësi të nënës, ndodhur në Durrës, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dhe paraqitur dokumente³⁵ në lidhje me faktin se kontrata e shitblerjes përfundimtare të apartamentit ende nuk është lidhur, për arsye të problemeve tekniko-ligjore të ndërtimit, për të cilin është aplikuar për legalizim në ASHK Drejtoria Vendore Durrës.

Analiza e mundësisë financiare për krijimin e kësaj pasurie

9.2.5 Komisioni, referuar tri burimeve të krijimit të apartamentit, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në pyetësonin nr. 2, analizoi dokumentacion në lidhje me:

a) *Të ardhurat nga shitja e tokave të përfituara nga nëna e subjektit me trashëgimi*

Sipas aktit të pjesëtimit të truallit³⁶ me sip. 6,426 m², shtetasja J. B., nëna e subjektit të rivlerësimit dhe 12 bashkëpronarë të tjerë rezultojnë pronarë të 5,000 m² truall, të kthyer sipas vendimit nr. ***, datë 29.11.1994, të KKKPP-s, Bashkia Durrës dhe regjistruar sipas vërtetimit të pronësisë nr. ***, datë 11.1.1995, ndërsa sipas vendimit nr. ***, datë 13.6.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, janë pronarë të 4,916 m² truall, regjistruar në regjistrin nr. ***, datë 17.7.1996. Nëna e subjektit të rivlerësimit ka marrë në pronësi individuale 714 m². Nga shitja e sipërfaqes së përbashkët prej 3,490 m², nëna e subjektit ka përfutur vlerën monetare për sipërfaqen 388 m².

Subjekti, në pyetësonin nr. 2, ka depozituar: (i) kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.1999, ku pronarja J. B. shet 714 m² truall me çmimin 1,950,000 lekë; (ii) kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.12.1997, me të cilën J. B. dhe 12 bashkëpronarët e tjerë shesin 320 m² truall me çmimin 540,000 lekë; (iii) kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.12.1997 me të cilën J. B. dhe 12 bashkëpronarët e tjerë shesin 300 m² truall me çmimin 600,000 lekë; (iv) kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë e plotësuar me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.1999, me të cilën shtetasja J. B. dhe 12 bashkëpronarët e tjerë shesin 300 m² truall me çmimin 600,000 lekë (në pyetësonin nr. 3 subjekti ka sqaruar se kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., mban nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.1999 dhe e ka bashkëlidhur përgjigjes këtë kontratë datë 9.3.1999); (v) kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.1.2000, me të cilën shtetasja J. B. dhe 12 bashkëpronarët e tjerë shesin 338.75 m² truall me çmimin 1,016,250 lekë; (vi) kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.8.2000, me të cilën shtetasja J. B. dhe 12 bashkëpronarët e tjerë shesin 237 m² truall me çmimin 810,000 lekë.

Ndër të tjera, në shpjegimet e saj, subjekti ka deklaruar se këto të ardhura nëna e saj i ka depozituar në Bankën e Kursimeve.

Raiffeisen Bank³⁷ konfirmon veprimin e derdhjes së shumës 2,100,000 lekë, në datën 12.1.1999, në depozitën e kursimit me nr. ***, në emër të shtetasës J. B.. Rezulton se të ardhurat e përfituara nga kontratat e shitjes së tokave deri në momentin e depozitimit janë në shumën 2,065,544 lekë³⁸.

³⁵ Subjekti ka bashkëlidhur shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2020, të ASHK-së drejtuar Drejtorisë Vendore Durrës e për dijener administrativ të pallatit, ku evidentohet kërkesa e administratorit për konkludimin e procedurave të legalizimit të pallatit, pasi ai e ka plotësuar dokumentacionin tekniko-ligjor, si dhe evidentohet kërkesa e ASHK-së Qendrore për Drejtorinë Rajonale Durrës që të verifikojë situatën dhe të marrë masat përkatëse për të njoftuar firmën ndërtuese dhe dokumente të tjera.

³⁶ Akt pjesëtimit truallit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.1997, bashkëlidhur pyetësorit nr. 2.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2023, e Raiffeisen Bank.

³⁸ (540,000 lekë + 600,000 lekë) * 11.11% + 1,950,000 lekë = 2,065,544 lekë.

Kjo depozitë është shtuar ndër vite me interesat e akumuluar, duke arritur në datën 1.11.2004, në vlerën 2,625,416 lekë.

b) Të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm në Durrës, me çmimin 2,600,000 lekë.

ASHK ka konfirmuar³⁹ se shtetasit J., K. dhe E. B. (K. dhe E. B. kanë fituar pronësinë nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë) me kontratën e shitjes datë 31.5.2007 i kanë shitur apartamentin me sip. 56.8 m², të ndodhur në Durrës, shtetasit M. K., me çmim 2,600,000 lekë. Bashkëlidhur praktikës së ASHK-së ndodhet e depozituar mandatpagesa nr. ***, datë 5.6.2007, me të cilën shtetasja J. B. ka paguar për llogari të ASHK-së Durrës tatimin mbi shitjen 26,000 lekë.

Nga veprimet bankare në Raiffeisen Bank konfirmohet se në datën 31.5.2007, shtetasi M. K. ka derdhur në llogarinë bankare të shtetases J. B. shumën 20,883.53 euro, për pagesën e çmimit 2,600,000 lekë të kontratës së shitjes së apartamentit.

c) Kontributi i vëllait nëpërmjet të ardhurave nga punësimi dhe nga një hua në shumën 6,500 euro, marrë nga punëdhënësi i tij

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka depozituar dokumentacion⁴⁰ provues ligjor në lidhje me të ardhurat e vëllait të saj K. B. nga punësimi për periudhën gusht 2003 – dhjetor 2015, në shumën 3,533,481 lekë, si dhe vërtetimin nga punëdhënësi i tij në lidhje me huamarrjen e shumës 6,500 euro, sipas faturës së pagesës nr. ***, datë 7.2.2006, në shumën 1,500 euro dhe faturës së pagesës nr. ***, datë 15.1.2007, në shumën 5,000 euro.

Të ardhurat e vëllait nga punësimi plotësojnë kriteret e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kështu që kanë shërbyer si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë së apartamentit me çmimin 44,400 euro.

9.2.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me dokumentacionin ligjor të pagesave për apartamentin, ka depozituar llogaritë bankare të nënës së saj në Raiffeisen Bank dhe mandatarkëtimet, si vijon:

- i) mandatarkëtimi nr. ***, datë 7.2.2006, në shumën 13,300 euro, me përshkrimin “Kësti i parë për prenotim ap. *** te banesa ***”, konvertuar në 1,629,250 lekë me kursin e këmbimit 122.5, sipas Bankës së Shqipërisë datë 7.2.2006;
- ii) mandatarkëtimi nr. ***, datë 16.1.2007, në shumën 15,500 euro, me përshkrimin “Arkëtim për apartamentin, objekti ***”, konvertuar në 1,940,600 lekë me kursin e këmbimit 125.2, sipas Bankës së Shqipërisë datë 16.1.2007;
- iii) mandatarkëtimi nr. ***, datë 29.1.2008, në shumën 15,500 euro, me përshkrimin “Për ap. ***, likuidim kësti”, konvertuar në 1,896,270 lekë me kursin e këmbimit 122.34, sipas Bankës së Shqipërisë datë 29.1.2008.

9.2.7 Në pyetësorin nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime në lidhje me destinacionin e përdorimit të shumave 738,600 lekë, 750,000 lekë dhe 400,000 lekë, që janë tërhequr në llogaritë bankare në Raiffeisen Bank nga nëna e saj, përkatësisht në datat 12.12.2005, 7.2.2006 dhe 10.7.2006.

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 5.3.2021, e ASHK Drejtoria Vendore Durrës, drejtuar Komisionit.

⁴⁰ Vërtetim nr. *** prot., datë 22.4.2023, e Kishës *** të Shqipërisë.

9.2.8 Subjekti ka shpjeguar se referuar deklarimeve të nënës dhe shkresës nr. *** prot., datë 22.11.2018, të Raiffeisen Bank (ashtu siç ka shpjeguar edhe në pyetësin nr. 2), llogaria bankare është krijuar me burim të ardhurash nga shitja e tokës që nëna ka trashëguar prej babait të saj ish-pronar dhe si llogari është hapur fillimisht në Bankën e Kursimeve me gjendje konkrete në shumën 2,655,796 lekë, sipas inventarit janar 2001 dhe ka kaluar në Raiffeisen Bank në datën 30.9.2004, me përshkrimin “Teprica”, në shumën 2,598,653.21 lekë.

9.2.9 Lidhur me këtë shumë parash, sipas dokumentacionit bankar të sipërpërmendur janë kryer disa lëvizje bankare si, vendosje depozitë me afat, depozitë fleksi, lëvrim interesi bankar, tërheqje dhe vendosje depozitë e re me afat, pagimi tatimi mbi interes, etj., ku përfshihen edhe lëvizjet e konstatuara nga Komisioni. Këto lëvizje bankare të dokumentuara në Raiffeisen Bank, për shumën e parave me origjinë nga Banka e Kursimeve, zënë fill në datën 1.10.2004, ku evidentohet shuma 2,598,653.21 lekë, për të përfunduar në datën 11.1.2007, ku është tërhequr shuma e fundit e mbetur 835,128 lekë. Ky burim të ardhurash, ashtu siç është shpjeguar edhe në pyetësin nr. 2, po sipas deklarimeve të nënës, kanë shërbyer për pagesën e çmimit të apartamentit në Lagjen nr. ***, Durrës, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 7.2.2006.

9.2.10 Nga veprimet bankare të nënës në Raiffeisen Bank, rezulton se ajo ka tërhequr shuma të konsiderueshme monetare nga llogaritë e saj, të cilat kanë si burim të ardhurat nga shitja e tokave dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm në Durrës. Konkretisht:

- i) në datën 12.12.2005 tërhequr shuma 738,600 lekë;
- ii) në datën 7.2.2006 tërhequr shuma 750,000 lekë;
- iii) në datën 10.7.2006 tërhequr shuma 400,000 lekë;
- iv) në datën 11.1.2007 tërhequr shuma 835,128 lekë;
- v) në datën 29.1.2008 tërhequr shuma 15,098 euro.

9.2.11 Për pagesën 13,300 euro, në datën 7.2.2006, nëna e subjektit ka pasur në dispozicion shumat 738,600 lekë, 750,000 lekë (me burim depozitën e hapur me të ardhurat nga shitja e tokave) dhe 183,750 lekë (ose 1,500 euro me burim kontributin e vëllait nga huaja). Në total, shumat bëjnë 1,672,350 lekë, të mjaftueshme për të paguar këstin e parë prej 1,629,250 lekësh të apartamentit.

9.2.12 Për pagesën 15,500 euro, në datën 16.1.2007, nëna e subjektit ka pasur në dispozicion shumat 400,000 lekë, 835,128 lekë (me burim depozitën e hapur me të ardhurat nga shitja e tokave) dhe 626,000 lekë (ose 5,000 euro me burim kontributin e vëllait nga huaja). Në total, shumat bëjnë 1,861,128 lekë. Diferenca prej 79,472 lekësh (1,940,600 – 1,861,128) duket se është mbuluar me kontributin e vëllait të subjektit me të ardhurat nga punësimi, ashtu siç ka deklaruar vetë subjekti në pyetësin nr. 2.

9.2.13 Për pagesën 15,500 euro, në datën 29.1.2008, nëna e subjektit ka pasur në dispozicion shumën e tërhequr nga banka prej 15,098 euro, me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit. Diferenca prej 402 euro (15,500 – 15,098) duket se është mbuluar me kontributin e vëllait të subjektit me të ardhurat nga punësimi, ashtu siç ka deklaruar vetë subjekti në pyetësin nr. 2.

9.2.14 Pas shqyrtimit dhe analizës së provave dhe deklarimeve të subjektit gjatë hetimit, Komisioni nuk konstatoi rrethana që e lidhin subjektin e rivlerësimit me këtë pasuri të blerë nga nëna e saj, që të krijonin ndonjë dyshim për pasuri të fshehur të subjektit.

9.2.15 Për sa më lart, deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

9.3 Në lidhje me adresat e banimit që ka deklaruar në pyetësonin nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime në pyetësonin nr. 2, si vijon:

- Për periudhën 2007 – janar 2009, ka banuar në adresën Lagjja nr. ***, rruga “****”, në banesën që nëna J. B. ka marrë me kontratë huapërdorjeje, pa kundërshpërblim, nga shtetasi A. M., pronar i kësaj banese, sipas kontratës⁴¹ së datës 20.4.2007.
- Për periudhën 2009 – dhjetor 2009, ka banuar në adresën Lagjja nr. ***, rruga “****”, pallati nr. ***, h. ***, Rajoni nr. ***, Durrës, pranë zyrës së gjendjes civile të lagjes, apartament kati ***, që nëna J. B. ka marrë me qira nga shtetasi G. H., pronar i këtij apartamenti, sipas kontratës datë 1.1.2009.

9.3.1 Bashkëlidhur përgjigjes së pyetësonit nr. 1, subjekti ka depozituar edhe kontratat e lartpërmendura.

9.3.2 Edhe për këto pasuri, Komisioni kreu hetim për të verifikuar nëse kemi të bëjmë me pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit.

9.3.3 Komisioni ka administruar⁴² kontratën e huapërdorjes datë 20.4.2007, e lidhur midis nënës së subjektit të rivlerësimit dhe qiradhënësit A. M., për marrjen me qira të banesës 2 kat në Durrës, me huapërdorje pa afat dhe pa kundërshpërblim.

9.3.4 Në pyetësonin nr. 2, subjekti ka shpjeguar se me qiradhënësin A. M., familja e saj është njohur në kishë që nga viti 1993, si besimtarë prej shumë vitesh. Kjo përbënte një garanci për mirëmbajtjen e banesës, në kushtet kur qiradhënësi dhe bashkëshortja e tij ishin zhvendosur në Greqi/SHBA. Për sa i përket shtetasit G. H., janë njohur rastësisht kur subjekti dhe familja e saj, ndërkohë që ishin duke pritur të hynin në apartamentin e porositur nga nëna e saj në Lagjen nr. ***, Durrës, po kërkonin vetë dhe me agjenci një shtëpi me qira 1-vjeçare dhe konkluduan kontratën nëpërmjet agjencisë.

9.3.5 ASHK Drejtoria Rajonale Durrës konfirmon⁴³ se nuk ka prona të paluajtshme të regjistruara në emër të shtetasve A. M. dhe G. H.

9.3.6 Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacionin që provon pronësinë e këtyre shtetasve mbi këto apartamente, por subjekti ka shpjeguar se ajo dhe familjarët e saj i kanë humbur kontaktet me këta shtetas që nga momenti kur janë larguar nga banesat e tyre, prandaj nuk mund të disponojë dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni.

9.3.7 FSHU-ja konfirmon⁴⁴ se me gjeneralitetet A. M. (pa atësi dhe datëlindje) ekziston vetëm një kontratë e lidhur nr. *** (familjare) në instancën ***, Durrës, në datën 25.5.1998, ndërsa me

⁴¹ Kontratë huapërdorjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.4.2007.

⁴² Kontratë huapërdorjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.4.2007, me shkresën datë 17.4.2023, të noteres M. N.. Bashkëlidhur kësaj kontrate është edhe kontrata e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.7.1996, ku rezulton se këtë banesë shtetasi A. M. e ka në bashkëpronësi me shtetasit J., Gj. e M. M..

⁴³ Shkresë nr. *** prot., datë 10.5.2023, e ASHK Drejtoria Rajonale Durrës.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 26.5.2023, e FSHU-së.

gjeneralitetet G. H. (pa atësi dhe datëlindje) ekziston një kontratë e lidhur nr. *** (familjare) në instancën ***, Durrës, në datën 15.4.1998.

9.3.8 Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasve A. M. dhe G. H., por nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë⁴⁵.

9.3.9 Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me marrëdhëniet e qirasë dhe të huapërdorjes së banesës që ka lidhur nëna e subjektit të rivlerësimit, si dhe me adresat e banimit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, duke mos u ngritur dyshime për pasuri të fshehura të subjektit.

10. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Autoveturë marka “Volkswagen Golf”, vit prodhimi 1992, me targë *. Vlera: 1,100 euro. Pjesa takuese: 100%. Data e krijimit të pasurisë 29.10.2004”.** Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e automjetit me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.8.2014, blerësit E. L. Kjo shumë parash është mbajtur gjendje cash. Vlera: 70,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

10.1 Komisioni administroi⁴⁶ dhe shqyrtoi dosjen e këtij automjeti, nga rezultoi se: (i) me kontratë shitblerjeje datë 15.10.2004, subjekti ka blerë nga pronari Th. R. (Gjermani) automjetin me çmimin 1,100 euro dhe e ka zhdoganuar në datën 29.10.2004, me vlerë totale 293,071 lekë (155,351 taksë zhdoganimi + 1,100 euro x 125.2); (ii) me kontratë shitjeje⁴⁷ datë 11.8.2014, subjekti ia shet automjetin blerësit E. L., me çmimin 70,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

10.2 Në pyetësin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë burimin e krijimit të këtij automjeti dhe ta provojë atë me dokumentacion ligjor. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se vlera e blerjes së automjetit dhe zhdoganimit të tij kanë si burim të ardhurat e përfituara nga paga e saj.

Analiza e mundësisë financiare për krijimin e kësaj pasurie

10.3 Komisioni kreu analizën financiare të burimit të ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie për periudhën 1.1.2004 – 15.10.2004, duke konsideruar: (i) të ardhurat nga pagat e subjektit; (ii) shpenzimet e jetesës; (iii) shpenzimet e udhëtimit; (iv) blerjen e automjetit. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit në datën 15.10.2004.

Tabela nr. 2

	Përshkrimi	1.1.2004 – 15.10.2004
Nr.	Të ardhurat	719,430
1	Të ardhura nga paga e subjektit	719,430
	Detyrime	0
	Shpenzime	93,074
1	Shpenzime jetike	74,063
2	Shpenzime udhëtimi	19,011
	Pasuri	293,071
1	Automjet tip “Golf”, blerë më 15.10.2004	293,071
	Të ardhura + detyrime – shpenzime – pasuri	333,286

⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., maj 2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

⁴⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 31.3.2023, të DPSHTRR-së, drejtuar Komisionit.

⁴⁷ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.8.2014, notere A. P. (S.).

10.4 Për sa më lart, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë pasuri.

Analiza financiare për periudhën 1.10.2002 – 2016

11. Nga analiza e deklaratave të interesave pasurorë privatë/vjetorë dhe asaj *Vetting* për periudhën e hetimit 1.10.2002 – 2016, të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka dërguar⁴⁸ pranë Komisionit raportin nr. ***, datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Elena Pelushi, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 26.4.2023, të KDZH-së. Sipas këtij raporti, Grupi i Punës i AKSIK-së, në përfundim të verifikimit, ka konkluduar se:

a) Subjekti i rivlerësimit ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato që ka deklaruar vetë në deklaratën për kontrollin e figurës.

b) Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

2. Nga hetimi i kryer, Komisioni nuk ngriti dyshime për sa i përket përshtatshmërisë së subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, në lidhje me kriterin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Grupi i Punës pranë KLP-së, në bazë të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016 ka hartuar raportin⁴⁹ mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Elena Pelushi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, miratuar me vendimin nr. ***, datë 24.2.2023.

2. Ky raport, për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016, është hartuar duke u bazuar në përshkrimin dhe analizimin e tri grupeve të burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme. Në raport janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të vlerësimit: (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative; (iii) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësitë personale dhe angazhimi profesional, për të cilat Grupi i Punës ka konkluduar me një vlerësim pozitiv për subjektin e rivlerësimit⁵⁰.

⁴⁸ Me shkresat nr. *** prot., datë 27.4.2023 dhe nr. *** prot., datë 31.10.2017, të AKSIK-së.

⁴⁹ Raporti nr. *** prot., datë 27.4.2023, i KLP-së.

⁵⁰ **Aftësitë profesionale**, ku përfshihen: a) njohuritë ligjore dhe b) arsyetimi ligjor. Në lidhje me njohuritë ligjore, subjekti i rivlerësimit tregon korrektësi në zbatimin të ligjit. Në tre aktet procedurale ligjore të paraqitura prej tij dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet; analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit; respekton parashikimet ligjore dhe urdhrin nr. ***, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”. Rezulton se qëndrimet e subjektit të rivlerësimit janë mbështetur nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në lidhje me arsyetimin ligjor, subjekti i rivlerësimit ka aftësi të mira. Aktet prej saj janë të konceptuara përgjithësisht me tri pjesë dhe në përmbajtje të tyre subjekti u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje; formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori; analizohen në mënyrë të hollësishme ose të përmbledhur elementet e veprës penale, objekt hetimi. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

3. Raporti gjithashtu është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e informacioneve, si vijon:

C/1. Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit

4. Formulari i vetëdeklarimit, dorëzuar në datën 23.1.2017, paraqitet i nënshkruar pa mangësi nga subjekti, i plotë, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, duke bashkëlidhur dokumentacionin e nevojshëm⁵¹. Subjekti ka paraqitur edhe vendimet e Prokurorit të Përgjithshëm, “Për vlerësimin e punës së prokurorit” për vitet 2012, 2014 dhe 2016, për prokurorin Elena Pelushi, në nivel “shumë mirë”.

5. Prokurore Elena Pelushi, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. ***, datë 1.10.2001, është emëruar “Prokuror në stazh” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. ***, datë 23.9.2002, është emëruar “Prokuror” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Me urdhrin nr. ***, datë 4.4.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm⁵², subjekti i rivlerësimit është caktuar në detyrën e zëvendës drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Me urdhrin nr. ***, datë 19.4.2012, të

Aftësitë organizative, ku përfshihen: a) *aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*; b) *aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*; c) *aftësia për të administruar dosjet*.

Në lidhje me *aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë* – referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 16.10.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe procesverbalit “Për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes së 5 dosjeve për subjektin e rivlerësimit, znj. Elena Pelushi”, datë 16.10.2020, të KLP-së, vërtetohet se gjatë periudhës së rivlerësimit, subjekti ka trajtuar gjithsej 175 çështje penale. Subjekti ka ushtruar kompetencat që ligji i njej prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore, ka kryer detyrat në pajtim me pikat 2 dhe 2.1 të urdhrin nr. ***, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”. Referuar të dhëna statistikore dhe detyrimeve ligjore si zëvendës drejtues, konstatohet se subjekti ka përballuar ngarkesë pune normale gjatë periudhës së rivlerësimit. Subjekti respekton afatet, sipas kërkesave të ligjit procedural penal; paraqet qëndrimin e saj para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve me mospërgatitjen e saj. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit është efikase dhe efektive. Në lidhje me *aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore*, subjekti merr pjesë në gjykim si palë dhe përfaqëson Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim. Në lidhje me *aftësinë për të administruar dosjet*, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht; materialet janë të vendosura në rend kronologjik; tregojnë faktin penal dhe qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe disponimin e Gjykatës.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, që përfshin: a) *etikën në punë*; b) *integritetin*; c) *paanësinë*. Në lidhje me *etikën në punë*, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezultojnë të ketë pasur ankesa për qëndrime jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Në lidhje me *integritetin*, nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në lidhje me *paanësinë*, nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit; nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar; asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, ku përfshihen: a) *aftësitë e komunikimit*; b) *aftësia për të bashkëpunuar*; c) *gatishmëria për t'u angazhuar*. Në lidhje me *aftësinë e komunikimit*, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Në lidhje me *aftësinë për të bashkëpunuar*, nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e Prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në lidhje me *gatishmërinë për t'u angazhuar*, subjekti i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, duke marrë pjesë në trajnime pranë kësaj shkolle.

⁵¹ Vërtetim nr. ***, datë 13.10.2016, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës Tiranë dhe certifikatat përkatëse të trajnimeve ku ka marrë pjesë subjekti; fotokopje e diplomës të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës Tiranë me nr. ***, nr. *** regjistri, së bashku me certifikatën e vlerësimit; fotokopje e diplomës nr. ***, datë 10.7.1999, nga Universiteti i Tiranës, me certifikatën e notave; fotokopje e diplomës nr. ***, datë 10.9.2021, Master në Shkenca Penale; fotokopje e dëshmisë së gjuhës frënge, datë 13.1.1997 regj., lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Tiranë; vendime për vlerësimin e punës së prokurorit për vitet 2012, 2014 dhe 2016.

⁵² Sipas shkresës nr. *** prot., datë 4.4.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit lirohet nga detyra e zëvendësdrejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe caktohet prokuror në Njësisë e Përbashkët Hetimore kundër Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit në këtë Prokurori. Me vendimin nr. ***, datë 27.1.2021, të KLP-së, është komanduar në detyrën e inspektorit pranë ILD-së, për një periudhë 5-vjeçare, deri në datën 8.2.2026.

Tri dokumentet ligjore të përzgjedhura për vlerësim nga subjekti i rivlerësimit

6. Dokumenti nr. 1 – kërkesë për lejimin e përgjimit të bisedave telefonike; kërkesë për lejimin e kontrollit të vendit dhe të banesës; kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***; konkluzionet përfundimtare; ankim ndaj vendimit të gjykatës në kuadër të procedimit penal nr. ***, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. ***, të regjistruar në ngarkim të të pandehurve D. Sh., L. A. (K.), V. H., A. N. dhe S. D., të akuzuar se kanë kryer veprat penale “falsifikim i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” dhe “falsifikim i vulave, i stampave ose i formularëve” (nenet 189/2/3 dhe 190/2/3 të Kodit Penal).

Ka rezultuar e provuar se në bashkëpunim me të pandehurit D. Sh., K. F., L. A., V. H., S. D. dhe tre shtetas të tjerë të paidentifikuar, si shtetas të cilët kanë përfituar dokumentet biometrike, e pandehura A. N. ka kryer në 7 raste veprat penale “falsifikim i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën ose vizën në bashkëpunim (neni 189/3, 25 i Kodit Penal) dhe “falsifikim i vulave, i stampave ose i formularëve” nga personi që ka për detyrë hartimin e tyre në bashkëpunim (neni 190/3, 25 i Kodit Penal).

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, në dokumentin “Ankim ndaj vendimit të gjykatës në kuadër të procedimit penal nr. ***”, ka kërkuar ndryshimin e vendimit datë 9.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka vendosur masa dënimi më të ulëta për të pandehurit në krahasim me masat që ka kërkuar subjekti; ka ndryshuar cilësimin ligjor të dy veprave penale në ngarkim të të pandehurës A. N., që kjo i ka kryer disa herë në favor të disa personave në dy vepra penale, pa cituar përsëritjen; ka aplikuar në disa raste nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale, edhe pse nuk ekzistonin kushtet për këtë.

7. Dokumenti nr. 2 – kërkesë për gjykim të procedimit nr. ***; konkluzionet përfundimtare; ankim ndaj vendimit të gjykatës në kuadër të procedimit penal nr. *** të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar këtë procedimin penal për kryerjen e veprës penale “kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, e kryer në bashkëpunim (nenet 172 dhe 25 të Kodit Penal), në ngarkim të shtetasve L. D. dhe Sh. D..

Në datën 26.9.2013, grupi i antikontrabandës së Degës së Doganës Durrës ka gjetur në automjetin me targë ***, në përdorim të shtetasit L. D., një bidon me rreth 135.8 litra naftë, me ndërtim “Gazoil me një përmbajtje squfuri jo më tepër se 0.001% ndaj peshës”. Për këtë sasi naftë, ky shtetas nuk kishte asnjë dokument justifikues, por ka shpjeguar se e ka marrë nga peshkarexha e vëllait të tij Sh. D.. Këtë vepër penale i pandehuri L. D. e ka kryer në bashkëpunim me kapitenin

e peshkarexhës I. Sh., i cili ka blerë naftën (sasia 7,247 litra) në Malin e Zi, për llogari të Lavdërimin, duke mos deklaruar si destinacion “furnizim bordi”, por destinacion “peshkim”.

Komisioni vëren se në dokumentin “Konkluzionet përfundimtare”, subjekti i rivlerësimit, pasi ka përshkruar dhe trajtuar qartë rrethanat e bashkëpunimit, ka kërkuar: (i) deklarin fajtor të të pandehurit L. D., për veprën penale “kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, e kryer në bashkëpunim, dënimin e tij me 18 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin me 12 muaj burgim; (ii) deklarin fajtor për këtë veprë të të pandehurit I. Sh., dënimin me 9 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin me 6 muaj burgim.

8. Dokumenti nr. 3 – kërkesë për gjykim të procedimit nr. ***; konkluzionet përfundimtare; kërkesë për paraqitjen e të dhënave kompjuterike; letërporosi drejtuar autoriteteve gjyqësore amerikane nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurit D. Xh., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “ndërhyrja në të dhënat kompjuterike” (neni 293/b/1 i Kodit Penal).

Shtetasi B. Z. ka paraqitur kallëzim penal, duke pretenduar se persona të panjohur kanë ndërhyrë në adresën e tij të postës elektronike, duke i ndryshuar fjalëkalimin dhe duke i marrë njëkohësisht posedimin e llogarisë së lidhur me këtë postë elektronike në portalin *Google Ad Sense*, llogari ku ishte mbledhur një shumë e konsiderueshme parash për çdo klikim në këtë portal.

Nga hetimet është provuar se ndërhyrja në adresën e postës elektronike të shtetasit B. Z. është bërë nga shtetasi D. Xh., i cili posedon dyqanin internet ku shtetasi B. Z. ka hapur dhe ka harruar të hapur adresën e tij elektronike. Paratë që kanë ardhur në llogarinë e shtetasit B. Z. janë marrë në një moment dobësie nga shtetasi D. Xh., i cili i ka kaluar përsëri në llogarinë e shtetasit B. Z., pra nuk ka pasur dëm ekonomik.

Komisioni vëren se tri dokumentet ligjore (kërkesa për gjykim, konkluzionet, ankimi dhe dokumente të tjera procedurale) pasqyrojnë në mënyrë të saktë ekstremitetet përkatëse, pasqyrojnë rrethanat e faktit, provat e administruara, elementet e figurës së veprës penale objekt hetimi etj., si dhe i pasqyrojnë ato në mënyrë të argumentuar e të mbështetura në bazën ligjore përkatëse.

Për sa më lart, nga shqyrtimi i tri dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk konstatoi problematika që e ngarkojnë atë me përgjegjësi në lidhje me kriterin profesional.

C/2. Pesë dosjet e përzgjedhura me sistem rastësor dhe objektiv

9. Dosja nr. 1 – kallëzimi penal nr. ***, datë 22.10.2013, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Dokumenti ligjor – vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”.

Shtetasi Xh. M. ka paraqitur kallëzim penal ndaj përmbauesit gjyqësor B. N. dhe shoqërisë “***”, duke pretenduar se ekzekutimi i detyrimeve të vendosura në vendimin nr. ***, datë 15.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku kreditor është shtetasi A. T. dhe debitor kallëzuesi, është

kryer nga përmbaruesi gjyqësor në kundërshtim me ligjin, duke mos e njoftuar debitorin dhe duke shkatërruar ambientin e brendshëm të objektit. Kallëzuesi pretendon se përmbaruesi gjyqësor ka kryer veprën penale “shpërdorim detyre”.

Nga hetimi që ka kryer subjekti i rivlerësimit është provuar se veprimet përmbarimore janë kryer në zbatim të vendimit nr. ***, datë 24.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që ka vendosur: (i) pranimin e kërkesës se kërkuarit A. T.; (ii) lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin civil nr. ***, datë 15.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; (iii) urdhërimin e shërbimit përmbarimor që të ekzekutojë në mënyrë të detyrueshme titullin ekzekutiv. Debitori Xh. M. është lajmëruar zyrtarisht dhe ka marrë dijeni për ekzekutimin vullnetar e më pas për ekzekutimin e detyrueshëm; debitori ka qenë i pranishëm familjarisht gjatë ekzekutimit të detyrueshëm, të cilët kanë kundërshtuar ekzekutimin, e për pasojë janë shoqëruar në Komisaratin e Policisë Durrës. Më tej ka vazhduar ekzekutimi në prani të bashkëshortes së debitorit, e cila nuk ka pasur vërejtje për ekzekutimin e kryer. Sipas procesverbalit datë 17.10.2013, kreditori A. T. ka liruar dhe marrë në dorëzim vetë objektin, duke qenë se debitori ka kundërshtuar ekzekutimin.

Në mbështetje të nenit 290, pika 1, shkronja “ç” dhe të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit për kallëzimin nr. *** të vitit 2013 dhe të njoftojë me këtë vendim kallëzuesin që ka të drejtën e ankimit në gjykatë.

Vendimi i mosfillimit të procedimit penal datë 23.12.2013 është marrë jashtë afatit 30-ditor, të parashikuar në udhëzim nr. ***, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, i Prokurorit të Përgjithshëm, për shkak edhe të pritjes së përgjigjes nga institucionet që u janë kërkuar aktet për verifikim. Nuk rezulton që të jetë paraqitur ankim ndaj vendimit të mosfillimit.

10. Dosja nr. 2 – procedimi penal nr. ***, i regjistruar në datën 28.5.2015 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Dokumenti ligjor – vendim datë 3.7.2015, “Për mosfillimin e procedimit penal”, përpiluar nga subjekti i rivlerësimit.

Nga Sektori kundër Krimit Ekonomik e Financiar në Drejtorinë e Policisë të Qarkut Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në datën 26.5.2015 është bërë testi i naftës në sasinë 25,168 litra, të ndodhur në depozitën nr. *** të shoqërisë “****” sh.a. Nga ky test ka rezultuar se produkti i naftës nuk e kaloi testin në vlerat -14.01%. Me kërkesë të kësaj shoqërie është kryer një test tjetër, që sërish rezultoi i pakalueshëm. Nisur nga këto rrethana, policia gjyqësore ka referuar në Prokurori se ky fakt krijon dyshime për naftë kontrabandë.

Sipas shkresës nr. *** prot., datë 2.7.2015, të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ka rezultuar se nga analizat laboratorike, parametrat e naftës në fuçinë nr. 14 janë brenda standardit të produktit “Lëndë djegëse Gazoil”, por ka rezultuar shmangie nga standardi për mostrën e karburantit të marrë nga depozita nr. 8 dhe për të cilën ISHTI ka vendosur gjobë për subjektin, konform ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar. Gjithashtu, ka rezultuar se shoqëria “****” sh.a. i ka paraqitur punonjësve të administratës tatimore dokumentacionin mbi gjendjen fizike e kontabël të

sasisë së karburantit që disponohej në datën 26.5.2015, për të cilën në aktin e konstatimit të mbajtur punonjësit e administratës tatimore nuk kanë cituar parregullsi.

Nga hetimi penal nuk rezultuan të dhëna që të tregojnë se karburanti është futur në territorin shqiptar në kundërshtim me rregullat ligjore të përcaktuara në Kodin Doganor dhe, si i tillë, t'i jetë shmangur pagimit të detyrimit doganor përkatës. Në këto rrethana, nuk jemi para kryerjes së veprimeve që kërkon dispozita që parashikon ruajtjen apo depozitimin e mallrave kontrabandë, as para ndonjë veprë tjetër penale që parashikohet në Kodin Penal, prandaj në mbështetje të nenit 290, pika 1/“ç” dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit.

Vendimi datë 3.7.2015, i mosfillimit i procedimit penal, është marrë jashtë afatit 30-ditor, të parashikuar në udhëzim nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, i Prokurorit të Përgjithshëm, për shkak të vonesës së përgjigjes nga institucionet ku janë kërkuar aktet për verifikim dhe kryerjes së veprimeve verifikuese.

Nuk rezulton të ketë ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal.

11. Dosja nr. 3 – procedimi penal nr. ***, i regjistruar në datën 23.11.2015 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprën penale “punësim i paligjshëm”, sipas paragrafit të parë, parashikuar nga neni 170/a/1 i Kodit Penal. Dokumenti ligjor – “Kërkesë për gjykim”, datë 29.2.2016, përpiluar nga subjekti i rivlerësimit.

Nga hetimet penale ka rezultuar se shoqëria “****”, megjithëse ka regjistruar në sigurimet shoqërore punonjësen e saj R. K. dhe i ka plotësuar librezën e sigurimeve, nuk i ka paguar sigurimet për periudhën e punësimit janar 2015 – shtator të vitit 2015, por vetëm për muajin janar 2015, pavarësisht se i ka pasur mundësitë financiare për t'i paguar ato.

Subjekti ka arritur në konkluzionin se administratori i kësaj shoqërie, z. N. P., ka konsumuar elementet e veprës penale “punësim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 170/a/1 i Kodit Penal dhe i ka kërkuar gjykatës gjykimin e këtij procedimi penal, ku në konkluzionet përfundimtare, konform kërkesave të nenit 378 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit N. P., për kryerjen e veprës penale “punësim i paligjshëm” dhe dënimin e tij me 4 muaj e 15 ditë burgim.*
- *Gjykata në caktimin e dënimit të mbajë parasysh zbatimin e nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin N. P. me 3 muaj burgim.*

12. Dosja nr. 4 – procedimi penal nr. ***, i regjistruar në datën 5.3.2014 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Dokumenti ligjor – vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 18.6.2015”, hartuar nga subjekti i rivlerësimit.

Nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, në IEVP-në Durrës është konstatuar dhënia e tri lejeve të veçanta për të dënuarin Rejdi Furxhi, në kundërshtim me ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të

paraburgosurve”, VKM-në Nr. 303, datë 25.3.2009, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, si dhe udhëzimin e ministrit të Drejtësisë nr. ***, datë 10.9.2009, “Për rregullimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta personave të burgosur”.

Subjekti i rivlerësimit ka kryer hetime të plota dhe në përfundim, në mbështetje të nenit 328, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin datë 18.6.2015, ka vendosur:

- *Pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014, për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.*
- *Kthimin pranë Spitalit Rajonal Durrës të kartelave mjekësore të sekuestruara, sipas përshkrimit të bërë në procesverbalin e sekuestrimit të oficerit të policisë gjyqësore G. H.*
- *Të njoftojë me këtë vendim të interesuarit, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë.*

Nuk rezulton të ketë ankim ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, viti 2014.

13. Dosja nr. 5 – procedimi penal nr. ***, i regjistruar në datën 26.2.2013 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Dokumenti ligjor – vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. ***/2013”, datë 1.11.2013.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 26.2.2013, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “korrupsion pasiv nga persona që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 259 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit E. Sh. dhe për veprën penale “korrupsion aktiv nga persona që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit K. Q..

Mbi bazën e materialeve të sjella nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Policisë Qarkut Durrës, ka rezultuar se shtetasi E. Sh., komandanti i togës së Policisë Rrugore Durrës, i kërkonte shuma mujore disa pronarëve të agjencive të ndryshme të udhëtarëve që dispononin automjete të transportit në linjën Tiranë-Durrës, me qëllim që të mos i ndalonte dhe të mos i hapte probleme me gjoha administrative.

Pas regjistrimit të procedimit penal u kryen veprimet hetimore si: pyetja e shtetasve K. Q. dhe E. Sh., në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime; janë pyetur shoferët e furgonëve, shtetasit L. I., E. Ç., G. B. dhe pronarët e furgonëve, shtetasit K. K., A. H. dhe E. K.; është kryer veprimi procedural i ballafaqimit midis shtetasve E. Sh. dhe K. Q., të cilët u kanë qëndruar deklarimeve të dhëna më parë; është administruar dokumentacioni i regjistrimit të automjeteve nga DRSHTRR-ja Durrës dhe informacioni nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës mbi urdhrat e punës së shtetasit E. Sh. dhe veprimtarinë administrative të kryer prej tij në datat objekt hetimi; janë kryer veprime të përgjimit të komunikimeve telefonike, vëzhgimeve të fshehta e fotografime, por nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë në interes të hetimit në këtë procedim penal.

Me vendimin datë 1.11.2013, në mbështetje të nenit 328, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “dh” të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka vendosur:

- *Pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2013, për veprën penale të parashikuar nga nenet 248 dhe 259 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit E. Sh. dhe për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit K. Q.*
- *Të njoftojë me këtë vendim të interesuarit të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë.*

Me shkresën nr. *** prot., datë 18.11.2013, vendimi i është njoftuar Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm Durrës, si dhe shtetasve nën hetim E. Sh. dhe K. Q., por nuk rezulton të ketë ankim ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. *** , viti 2013.

Për sa më lart, nga shqyrtimi i pesë dosjeve, nuk u konstatuan mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit, që e ngarkojnë atë me përgjegjësi në lidhje me kriterin profesional.

C/3. Të dhëna nga burime arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime

14. Referuar raportit të KLP-së, nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe nga burimet arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për subjektin e rivlerësimit E. P. rezulton se nga të dhënat e sektorit të burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, rezulton⁵³ se me Urdhrin nr. *** , datë 25.6.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm, është marrë masë disiplinore “vërejtje” ndaj subjektit të rivlerësimit, për shkak të shkeljes së ligjit gjatë veprimeve hetimore dhe në gjykimin e disa procedimeve penale. Ky vendim nuk rezulton të jetë ankimuar nga subjekti i rivlerësimit.

15. Për subjektin e rivlerësimit janë administruar informacionet si vijon:

- Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 1.12.2020, drejtuar KLP-së, ka konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi penal nr. *** , viti 2016 (bashkëlidhur dosja e skanuar 80 faqe), për të cilin pas verifikimeve është vendosur mosfillimi i procedimit penal.
- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 25.11.2020, ka konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit janë regjistruar dy kallëzime penale, për veprën penale “shpërdorim detyre” (neni 248 i Kodit Penal), për të cilët është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Konkretisht, kallëzimi i parë penal nr. *** , viti 2015, me vendimin e mosfillimit datë 1.9.2015 dhe kallëzimi i dytë penal nr. *** , viti 2020, me vendimin e mosfillimit datë 30.1.2020 (trajtuar në pikat në vijim).

16. Sektori i protokoll - arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 14.1.2021, ka dërguar informacion se për subjektin e rivlerësimit, gjatë periudhës 2006 – 2020, janë regjistruar dy ankesa, konkretisht ankesa nr. *** , viti 2019, e shtetasit G. Sh. dhe ankesa nr. *** , viti 2014, e shtetasit A. A. Drejtorja e Hetimit dhe Kontrollit të Ndjekjes Penale, me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2015, ka njoftuar ankuesin A. A. se pas kontrollit të ushtruar ka rezultuar se vendimi datë 27.10.2014, i pushimit të çështjes penale nr. *** , viti 2013, është i bazuar në ligj

⁵³ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2021, e Prokurorisë së Përgjithshme drejtuar KLP-së dhe shkresë nr. *** prot., datë 13.11.2020, e Drejtorisë së Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

e në prova, prandaj nuk janë gjetur shkaqe ligjore për shfuqizimin e tij. Me shkresën nr. *** prot., datë 6.1.2020, i është dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kallëzimi i paraqitur nga shtetasi G. Sh., për të cilin është marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal.

17. KLP-ja konfirmon se me vendimet përkatëse të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar në nivelin “shumë mirë” për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

18. Komisioni ka administruar përgjigjet e prokurorive të rretheve gjyqësore⁵⁴, që konfirmojnë se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është regjistruar kallëzim penal, procedim penal i filluar, pushuar apo i mosfilluar dhe nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme për persona të përfshirë në krimin e organizuar apo të dhëna që cenojnë figurën e subjektit.

19. Komisioni ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁵⁵, që konfirmon se për periudhën 2011 – 2021 ndaj subjektit të rivlerësimit janë regjistruar: (i) kallëzimi penal nr. ***, viti 2015, për veprën penale “shpërdorim detyre”, që është mosfilluar në datën 1.9.2015 (trajtuar në vijim në denoncimin nr. ***, datë 21.9.2022); (ii) kallëzimi penal nr. ***, viti 2020, për veprën penale “shpërdorim detyre”, që është mosfilluar në datën 30.1.2020. Nga shqyrtimi i fashikujve të dosjes penale të secilit kallëzim penal bashkëlidhur shkresës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se:

19.1 Në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, viti 2015 – denoncuesja ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë një padi, e cila është gjykuar nga gjyqtarja R. P.. Gjatë gjykimit denoncuesja ka kërkuar përjashtimin e kësaj gjyqtareje dhe kërkesa është gjykuar nga një gjyqtar, i cili ka vendosur pushimin e gjykimit, për shkak se denoncuesja nuk është paraqitur në gjykim. Mbi bazën e ankimit të denoncueses, vendimi për pushimin e gjykimit është gjykuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku denoncuesja ka kërkuar përjashtimin e një anëtari të trupit gjykues dhe më pas edhe të relatorit të trupës që gjykonte këtë kërkesë. Këto kërkesa të denoncueses nuk janë pranuar nga trupa gjykuese, pasi nuk ishin në përputhje me nenin 75/4 të Kodit të Procedurës Civile.

19.2 Në datën 27.3.2015, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar kallëzimin penal nr. *** të denoncueses, për veprën penale “shpërdorim detyre” ndaj gjyqtarës R. P. dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë. Për hetimin e kësaj çështjeje penale u caktua prokurorja Elena Pelushi, e cila me vendimin datë 18.5.2015 ka vendosur mosfillimin e procedimit, me arsyetimin se veprimet e këtyre gjyqtarëve nuk përmbajnë elementet e veprës penale “shpërdorim detyre” dhe as të ndonjë vepre tjetër penale. Ky vendim i është njoftuar kallëzueses me shkresën nr. *** prot., datë 26.5.2015, të Prokurorisë.

⁵⁴ Përgjigjet e prokurorive të rretheve gjyqësore: Pogradec, me nr. *** prot., datë 24.2.2021; Sarandë, me nr. *** prot., datë 23.2.2021; Shkodër, me nr. *** prot., datë 24.2.2021; Lushnjë, me nr. *** prot., datë 23.2.2021; Mat, me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Elbasan, me nr. *** prot., datë 1.3.2021; Fier, me nr. *** prot., datë 23.2.2021; Krujë, me nr. *** prot., datë 5.3.2021; Gjirokastrë, me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Korçë, me nr. *** prot., datë 26.2.2021; Pukë, me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Dibër, me nr. *** prot., datë 23.2.2021; Tropojë, me nr. *** prot., datë 17.2.2021; Kavajë, me nr. *** prot., datë 10.3.2021; Lezhë, me nr. *** prot., datë 23.2.2021; Vlorë, me nr. *** prot., datë 24.2.2021; Përmet, me nr. *** prot., datë 17.2.2021; Durrës, me nr. *** prot., datë 17.2.2021; Kukës, me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Berat, me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Kurbin, me nr. *** prot., datë 18.2.2021.

⁵⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.

19.3 Ndaj subjektit të rivlerësimit, kallëzuesja ka bërë kallëzimin penal nr. ***, i regjistruar në datën 16.6.2015 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në kallëzim denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit ka mosfilluar hetimet vetëm, duke studiuar kallëzimin dhe nuk ka bërë hetime.

19.4 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin datë 1.9.2015, ka vendosur mosfillimin e hetimeve ndaj subjektit të rivlerësimit Elena Pelushi, me arsyetimin se në vendimet gjyqësore të çështjeve të përmendura nga denoncuesja në kallëzim dhe në vendimin që ka disponuar subjekti i rivlerësimit nuk konstatohen elementet e veprës penale “shpërdorim detyre” dhe as të ndonjë vepre tjetër penale. Gjithashtu, në vendimin datë 1.9.2015 citohet se nga përmbajtja e fashikullit të dosjes penale rezulton se prokurorja Elena Pelushi ka kryer hetime dhe ka administruar aktet e nevojshme nga dosjet gjyqësore që pretendon kallëzuesja.

20. Në lidhje me kallëzimin penal nr. *, viti 2020**, rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës në datën 31.5.2019 ka regjistruar kallëzimin penal nr. *** të shtetasit G. Sh. ndaj prokurorit G. H., për veprën penale “shpërdorim detyre”, pasi shtetasi G. Sh. pretendon se ky prokuror nuk ka kryer asnjë hetim për kallëzimin penal nr.***, që ka bërë ndaj shtetasve A. e L. K. dhe në datën 15.1.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

20.1 Ky kallëzim është hetuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili në datën 14.6.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, me arsyetimin se faktet e pretenduara në kallëzim nuk përbëjnë veprë penale “shpërdorim detyre” apo ndonjë veprë tjetër penale. Nga përmbajtja e vendimit datë 14.6.2019, rezulton se subjekti gjatë hetimit ka administruar dosjen e procedimit penal që ka hetuar prokurori G. H., i cili nga ana e tij ka pyetur përmbaruesin e çështjes ku ishte kreditor kallëzuesi G. Sh., ka pyetur debitorët dhe shtetas të tjerë që kishin dijeni për rrethanat e çështjes, ka administruar disa akte të depozituara me cilësinë e provës nga vetë kallëzuesi G. Sh. dhe ka arritur në përfundimin se mosmarrëveshja midis kallëzuesit kreditor dhe debitorëve ka natyrë juridiko-civile. Pra, nga ana e prokurorit G. H. janë kryer hetimet e nevojshme dhe vendimi i tij i është njoftuar kallëzuesit.

20.2 Më pas, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar kallëzimin penal nr. *** të shtetasit G. Sh. ndaj subjektit të rivlerësimit, për veprën penale “shpërdorim detyre”, ku pretendohet se subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit të procedimit penal nr. *** ka shpërdoruar detyrën, nuk ka kryer asnjë hetim, ka penguar zbulimin e së vërtetës dhe i ka dhënë koncept tjetër faktit penal të mosveprimit të prokurorit G. H., duke e quajtur bindje të brendshme të tij dhe ka vendosur mosfillimin e ndjekjes penale.

20.3 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin datë 20.2.2020, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2020, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, duke arsyetuar se nuk rezulton që prokurorja Elena Pelushi të ketë konsumuar elementet e veprës penale “shpërdorim detyre” dhe vendimi i saj është objekt i shqyrtimit të ligjshmërisë nga gjykata dhe jo nga prokuroria.

20.4 Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime hetimore dhe në veprimet e saj nuk ka elemente të veprës penale “shpërdorim detyre”, ndryshe nga sa pretendon kallëzuesi në kallëzim.

Për sa më lart, në të dyja kallëzimet penale, Komisioni nuk konstatoi mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit.

DENONCIME

21. Denoncim nr. *, datë 21.9.2022**, i shtetases R. R., e cila denoncon subjektin e rivlerësimit për shpërdorim detyre për interesa personale dhe, për këtë arsye, denoncuesja ka bërë kallëzimin penal nr. ***, i regjistruar në datën 16.6.2015 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë (trajtuar më lart në kreun C/3, “Kallëzimi penal nr. ***, viti 2015”).

Nga denoncimi rezulton se në datën 18.11.2020, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar edhe kallëzimin penal nr. *** të shtetases R. R. për veprën penale “shpërdorim detyre” ndaj disa subjekteve të rivlerësimit. Në këtë kallëzim pretendohet se gjyqtari Sh. M. ka dhënë vendime të qëllimshme të njëanshme, duke mos dhënë drejtësi për interesat e tij personale, ndërsa disa gjyqtarë të tjerë kanë ndihmuar shtetaset T. I. dhe G. B., duke dëmtuar ekonomikisht kallëzuesen R. Rr., pasi nuk kryejnë hetimet në lidhje me pretendimet e saj për marrëdhënien tregtare midis saj dhe këtyre shtetasve.

Me vendimin datë 27.11.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për këtë kallëzim, me arsyetimin se veprimet dhe mosveprimet e subjekteve të rivlerësimit që ka denoncuar kallëzuesja nuk përmbajnë elemente të veprës penale “shpërdorim detyre” apo të ndonjë vepre tjetër penale, pasi ata kanë përmbushur detyrat e tyre procedurale dhe palët që nuk janë dakord me vendimet e këtyre subjekteve kanë të drejtë t’i drejtohen Gjykatës së Lartë.

Vendimi datë 27.11.2020, i subjektit të rivlerësimit, është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 11.1.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Për sa më lart, në veprimet e subjektit të rivlerësimit Komisioni nuk konstatoi mangësi që mund ta ngarkojnë atë me përgjegjësi.

22. Denoncim nr.*, datë 15.11.2019, i shtetasit V. Ç.**⁵⁶ – në formularin e denoncimit, denoncuesi ka shënuar “Korrupsion nëpërmjet shpërdorimit të detyrës”. Në përmbajtjen e denoncimit pretendohet për korrupsion nëpërmjet shpërdorimit të detyrës nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe organit të akuzës në çështjen penale nr. ***, korrupsion të cilin denoncuesi e konstatoi në datën 12.11.2019.

Nga përmbajtja e denoncimit dhe akteve bashkëlidhur, rezulton se denoncuesi në datën 7.6.2019 është njoftuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin datë 29.5.2019, “Për mosfillimin e procedimit penal” në lidhje me kallëzimin e tij ndaj shërbimit postar të kësaj Prokurorie.

Në datën 7.6.2019, denoncuesi depoziton ankim kundër këtij vendimi datë 29.5.2019. Në datën 7.7.2019 zhvillohet seanca e parë gjyqësore për këtë vendim. Përfaqësuese e akuzës ishte prokurorja S. B., që më pas zëvendësohet nga subjekti i rivlerësimit, e cila në seancën e datës 30.10.2019 ishte prezente për herë të parë dhe ishte dakord me kërkesën e denoncuesit për shtyrje të seancës deri në pajisjen e tij nga gjykata me fotokopje të fashikullit hetimor të dosjes penale.

⁵⁶ Denoncim nr. ***, datë 19.11.2019, i Kolegjit, depozituar pranë Komisionit.

Më pas denoncuesi pretendon se në seancën e datës 12.11.20129, edhe pse ai u paraqit, nuk u thirr nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqi u zhvillua në mungesë të tij.

Me ankesën datë 30.10.2019, drejtuar kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, denoncuesi pretendon për mosveprim të gjyqtarës së çështjes dhe administratës gjyqësore, të cilët nuk i vinin në dispozicion kopje të fashikullit të çështjes penale. Me kërkesat datë 15.7.2019, 29.10.2019 dhe 14.11.2019, drejtuar gjyqtarës së çështjes E. K., denoncuesi kërkon kopje të procesverbalit dhe CD të seancave gjyqësore.

Bashkëlidhur denoncimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet e përmendura më lart.

Për sa më lart, rezulton se denoncuesi denoncon veprimet e gjyqtarës së çështjes dhe të administratës gjyqësore, por jo të subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk paraqiti asnjë provë apo *indicie* për veprime korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit Elena Pelushi.

Për këto arsye, Komisioni nuk e merr në konsideratë këtë denoncim.

23. Denoncim nr. *, datë 15.7.2019**, i shtetases Xh. S., e cila në formularin e deklaramit denoncon subjektin e rivlerësimit Elena Pelushi dhe z. N. T. për veprat penale “fshehje të pasurisë”, “korrupsion”, “kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar” dhe “pranim/shkëmbim dhuratash, favoresh, parash nga persona të përfshirë në krimin e organizuar”. Në vijim, denoncuesja pretendon se ka pasur kontratë pune me shoqëritë tregtare “****” sh.p.k., “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., me administrator L. Gj.. Kjo shoqëri nuk i ka paguar denoncueses sigurimet shoqërore e shëndetësore, nuk i ka dhënë pagën sipas kontratës së punës, si dhe nuk i ka paguar ditët e festave dhe pushimet vjetore e javore. Bashkëlidhur denoncimit denoncuesja ka depozituar⁵⁷ disa akte, nga ku rezulton se:

Në datën 14.6.2019, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar kallëzimin nr. *** të shtetases Xh. S., e cila kallëzon tre shoqëritë tregtare si më lart, për veprat penale “fshehje të ardhurash” dhe “mospagim taksash e tatimesh”. Në datën 26.6.2019, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal për këtë kallëzim, me arsyetimin se faktet nuk përbëjnë vepër penale. Në datën 1.4.2019, kallëzuesja ka paraqitur ankim gjyqësor ndaj këtij vendimi.

Nga përmbajtja e akteve bashkëlidhur denoncimit, përfshirë edhe vendimin e subjektit të rivlerësimit, rezulton se denoncuesja nuk ka depozituar asnjë provë apo *indicie* për të provuar veprimet e paligjshme (“fshehje të pasurisë”, “korrupsion”, “kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar”, “pranim/shkëmbim dhuratash, favoresh, parash nga persona të përfshirë në krimin e organizuar”), të cituara në adresë të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, denoncuesja pretendon për veprime që kanë të bëjnë me anën materiale të çështjes dhe jo me veprime procedurale të subjektit të rivlerësimit.

⁵⁷ Vendim datë 26.6.2019, për mosfillimin e procedimit penal; nxjerrje llogarie datë 7.5.2014, nga Union Bank, për lëvizjet në llogarinë bankare të shtetases Xh. S.; kërkesë ankimore datë 1.4.2019, e shtetases Xh. S., kundër vendimit datë 26.6.2019, të subjektit; ankesat datë 3.12.2018 dhe 5.2.2019, të shtetases Xh. S., drejtuar ISHPSHSH-së Durrës; kontratë individuale pune datë 24.3.2015 dhe datë 21.5.2016; informacion datë 21.12.2018, i ISHPSHSH-së Durrës, për trajtimin e ankesave të shtetases Xh. S.; fragment procesverbali i pyetjes së shtetases Xh. S. nga OPGJ-ja.

Për sa më lart, në referim të nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili nuk i jep Komisionit kompetencë të vlerësojë gjykimin e themelit të çështjes nga ana e subjektit, si dhe në kushtet e mungesës së provave për korrupsion, Komisioni nuk mund ta marrë në shqyrtim këtë denoncim.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

24. Në përmbledhje të konkluzioneve, referuar raportit të hartuar nga Grupi i Punës pranë KLP-së dhe dokumentacionit bashkëlidhur, si dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson se nuk janë konstatuar shkelje nga ana e subjektit të rivlerësimit, që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale dhe sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar neneve Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, si dhe krerëve V, VI e VII të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe të aftësive profesionale, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Elena Pelushi:

- a. Lidhur me kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë; ka bërë deklaram të saktë e të mjaftueshëm; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka zhvilluar procese në konflikt interesi.
- b. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se është “e aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 1/a të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elena Pelushi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, aktualisht në funksionin e inspektorit të komanduar pranë ILD-së.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 15.6.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj